



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M

PËR PROVIMIN E SHTETIT NË PROFESIONIN E RREGULLUAR TË PSIKOLOGUT SEZONI V

Për të gjithë kandidatët aplikantë për pjesëmarrje në provimin e shtetit në profesionin e rregulluar të Psikologut, ju bëjmë me dije se provimi do të zhvillohet në mesin e Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë:

Bulevardi "Zhan D'Ark", Nr. 23, Tiranë

Aplikimi do të kryhet online nëpërmjet Portalit Qeveritar e-Albania, duke përdorur shërbimin "Aplikim për provim shteti", gjatë periudhës **18 – 24 Nëntor 2024**. Lidhur me aplikimin e shtetasve të huaj, pasi të hyjnë në platformën e-Albania dhe të përdorin shërbimin "Aplikim për provim shteti", të zgjedhin opsionin "shtetas i huaj" dhe të plotësojnë fushat e kërkuara.

Gjatë aplikimit online, kandidati duhet të ngarkojë dokumentet e mëposhtme:

1. Diplomën/diplomat e programit të studimit për profesionin respektiv; (në një dokument të vetëm)
 - *Vetëm në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit ose në institucione të arsimit të lartë të mbyllura:
 - Vërtetimin për njohjen dhe njësimin e diplomës në rast se studimet janë përfunduar jashtë shtetit;
 - Dokumentacion të lëshuar nga institucioni përgjegjës për arkivat që provon lëshimin e diplomës/ diplomave, të fituara nga institucioni i arsimit të lartë të mbyllur dhe vërteton vlefshmërinë e tyre.
2. Dëshminë e pjesëmarrjes dhe përfundimit me sukses të praktikës profesionale të lëshuar nga UP-ja, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja;
3. Vetëm pas email-it të pranimit nga Urdhri Profesional, faturën e pagesës së kryer për llogari të QSHA-së, e cila brenda 72 orëve nga kryerja e aplikimit, duhet të ngarkohet në sistem në fushën që shfaqet pas vendosjes së kodit të gjurmimit. Pas ngarkimit të pagesës, kandidati duhet të qëndrojë në pritje të email-it të pranimit nga QSHA.

(linku i shkarkimit të faturës për arkëtim për kryerjen e pagesës: <https://qsha.gov.al/fatura-per-arketim/>)

Kandidati do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike si dhe portalit e-Albania në rubrikën Hapësira ime – Mesazhet e mia lidhur me statusin e aplikimit, si dhe do të mund të gjurmojë në çdo kohë aplikimin me anë të kodit të gjurmimit.

- Kandidati duhet të paraqitet pranë QSHA-së 30 minuta përpara orarit të publikuar dhe të jetë i pajisur me:
 - Letërnjoftim (Kartë ID ose Pasaportë, dokumenti origjinal);
 - Kopje të Kartës ID ose Pasaportës;
 - Faturën origjinale me vulën përkatëse, të pagesës së tarifës së provimit për llogari të QSHA-së, të kryer në një bankë të nivelit të dytë (sipas faturës për arkëtim të publikuar në www.qsha.gov.al, bazuar në herën e pjesëmarrjes në provim).
- Kandidati gjatë zhvillimit të provimit duhet të zbatojë rregullat e mëposhtme:
 - ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
 - ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të provimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
 - ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e provimit;
 - ndalohet duhani dhe konsumimi i ushqimit në mjediset e provimit.

Orari i pjesëmarrjes në provim do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të ketë ndryshime.

Lutemi që kandidatët e pranuar për pjesëmarrje në provim, të verifikojnë paraprakisht të dhënat në listat që do të publikohen në vijim në faqen www.qsha.gov.al dhe në rast pasaktësish t'i drejtohen Urdhrit Profesional.

Ju urojmë Suksese!